



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:150780

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05819575

K.DH.SHK.II.nr.832/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi Kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj-Sheremeti dhe Dren Rogova anëtarë, në çështjen juridike të paditësit “Daimler AG” me seli ne Gjermani, te cilin e përfaqëson Xhevdet Rama avokat nga Prishtina, kundër te paditurit “Rinas Trade” O.P, me seli ne Ferizaj rr.”Ahmet Kaçiku” nr.53, me nr. Biznesi 810662933, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa avokat nga Ferizaj, duke vendosur lidhur me ankesën e te paditurit, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës –Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.1452/22 dt.29.02.2024, me datën 12.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës “Rinas Trade” O.P, me seli ne Ferizaj rr.”Ahmet Kaçiku” nr.53, me nr. Biznesi 810662933.

II. VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës –Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.1452/22 dt.29.02.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës –Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike me aktgjykimin e atakuar, KE.nr.1452/22 dt.29.02.2024, ne pjesën e I te dispozitivit te aktgjykimit ka Aprovuar në tërësi si te bazuar kërkesëpadinë e paditësit Daimler AG dhe ka Vërtetuar se i padituri Rinas Trade O.P, me datën 18.06.2021 me importimin e 68 copë maica, ka shkelur markën tregtare të regjistruar të paditësit “Mercedes – Benz”. Ne pjesën e II te dispozitivit i Ndalohet të paditurit që në të ardhmen të ndërmarrë çfarëdo veprimi me të cilin mund të shkelen të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësit në çfarëdo mënyre, duke përfshirë importimin që përmbajnë elemente identike apo të ngjajshme me markat tregtare të regjistruara të paditësit. Ne pjesën e III te dispozitivit te aktgjykimit Urdhërohet shkatërrimi i produkteve të cekura si në pikën I të këtij dispozitivi dhe Obligohet i padituri Rinas Trade O.P, që me shpenzimet e tij dhe nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e mallit në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Ndërsa ne pjesën IV te dispozitivit te aktgjykimit detyrohet i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e

përgjithshme prej 521.00 € (pesëqind e njëzet e një euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të drejte të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj ankesën e të paditurit si të bazuar, aktgjykimin e goditur ta anuloj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Paditësi në përgjigje në ankesë e ka kundërshtuar ankesën si të pabazuar dhe ka propozuar që ankesa e të paditurit të refuzohet si e pathemeltë ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi me datë 09.07.2021, ka ushtruar padi kundër së paditurës për shkak të shkeljes së markës tregtare, duke i propozuar që gjykata të vërtetojë se i padituri ka bërë shkeljen e markës tregtare, ti ndalojë të njëjtit të vejë në qarkullim çfarëdo malli apo produkti tjetër i cili përben shkelje të markës tregtare dhe të obligohet i padituri që me shpenzimet e tij t'a asgjësojë mallin e ndaluar nga Doganat e Kosovës i cili është plotësuar me numrin 128/202 dt.18.06.2021 si dhe shpenzimet e magazinimit në shumën prej 68 copë maica me shenjen MERCEDES-BENZ si dhe të obligohet i paditurit në kompensim të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancat gjyqësore dhe pas administrimit të provave ka ardhur në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar sepse shenjat që janë përdorur në produktet e të paditurit janë identike me markat tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe tek secili konsumator. Gjykata i referohet në këtë rast nenit 8 të Ligjit nr.04/L-026 për Markat tregtare (LMT) duke arsyetuar se bartësi i markës tregtare të regjistruar gëzon të drejta dhe mund të ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e të njëjtit ta përdorin shenjen identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet e llojit të njëjtit apo të ngjashëm, po ashtu neni 8-13, neni 14 dhe 15-22 i LMT. I padituri me importimin apo vendosjen në treg të produkteve kontestuese pa autorizim të bartësit të drejtës së markës tregtare të regjistruar ka bërë shkelje ligjore të markës tregtare nr.9275 dt.06.03.2013 të paditësit. Andaj, duke u bazuar në dispozitat e neneve 8-13, neni 14 dhe 15-22 dhe nenit 28 të Ligjit për Markat Tregtare, gjykata e ka miratuar kërkesëpadinë dhe ka urdhëruar shkatërrimin e 68 cope maica të cilat bartin shenjen kontestuese "Mercedes-Benz" si dhe e ka urdhëruar të paditurin që mos të importojë mallra të tilla në të ardhmen.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk

është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës e Dytë, i vlerësoi të paqëndrueshme pretendimet ankimore të paditurit se në rastin konkret malli është origjinal i prodhuar në vende serioze të BE-së konkretisht në Gjermani dhe se ky mall i ka kaluar filtrat nga Dogana e Kosovës, ky mall është mall stoku, refuz toptan në lloje, dhe se i padituri gjithmonë importon mallra OUTLET.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT), të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund të ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjë identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta të: ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion (Nenet 8 – 13 i LMT); të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës (Neni 14 i LMT), si dhe të disponojë me markën tregtare të tij (Nenet 15 – 22 i LMT).

Mbajtësi i një marke tregtare, sipas Nenit 8 të LMT-së, ka të drejtë të ndalojë: vendosjen e markës së mbrojtur, nga mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e saj për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare; përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj sipas nenit 8 të LMT-së, përbën shkelje të markës tregtare. Shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëri prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se i padituri ka importuar mallra-tekstil-68 maica pa autorizimin e paditësit si bartës i të drejtave nga marka tregtare e regjistruar “Mercede-Benz”. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, fakti se mallrat janë origjinale ose jo, nuk përbën fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare. Bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të markës tregtare.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Dytë, nuk mund ta pranojë pretendimin ankimor se i padituri nuk e ka shkelur markën tregtare të paditësit pasi që mallin e ka origjinal nga Gjermania shtet ky rigoroz sa i përket markës tregtare dhe së malli kontestues është Outlet dhe është blerë si stok. Kjo gjykatë vlerëson se pretendimi i tillë është në kundërshtim me dispozitën e Neni12 të LMT-së nga shkaqet në vijim:

Ezaurimi (humbja) e të drejtave të markës tregtare (exhaustion of rights principle) – Doktrina apo parimi i “shterjes së të drejtave” pas “shitjes së parë” përbën parim sipas të cilit kontrolli i bartësit të markës tregtare mbi produktin apo shërbimin që bartë markën e tij tregtare pushon pas shitjes së parë të produktit. Ky parim i referohet kontrollit mbi produktin dhe jo kontrollin mbi markën tregtare si pronë e paprekshme. Kjo ndërlidhet me faktin se, një ndër të drejtat kryesore të bartësit të një marke tregtare është përdorimi i asaj marke në produktet e caktuara dhe që, ndër të tjera, nënkupton edhe hedhjen e produktit që mban atë markë në tregun e caktuar. Pra, hedhja e produktit në një treg të caktuar mund të bëhet vetëm nga bartësi i markës apo me pëlqimin e tij.

Shtete të ndryshme aplikojnë rregulla të ndryshme sa i përket parimit të “shterjes së të drejtave”. Disa shtete kanë aplikuar parimin e ezaurimit ndërkombëtar, që nënkupton se kontrolli i bartësit të markës tregtare mbi produktin pushon kur ky produkt të vendoset në tregun e cilitdo shtet në botë. Disa shtete aplikojnë parimin e ezaurimit regjional, ndërsa një numër i tyre aplikojnë parimin e ezaurimit nacional. Si rrjedhojë e kësaj mos harmonie midis shteteve të ndryshme, Marrëveshja TRIPS nuk ka adoptuar një politikë apo rregull sa i përket ezaurimit. Sipas neni 6 të Marrëveshjes TRIPS, secili shtet anëtar është i lirë që të adoptojë ezaurimin ndërkombëtar, regjional ose nacional përderisa nuk janë në kundërshtim me dy parimet tjera të TRIPS, përkatësisht parimin e trajtimit kombëtar dhe parimin e trajtimit më të favorshëm. Direktiva e BE-së [Direktiva e Parë e Këshillit 89/104/EEC (1988)] –, shumë qartë e përcakton parimin e ezaurimit regjional. Kjo nënkupton se bartësi i markës tregtare humb të drejtën të kontrollojë qarkullimin e produktit i cili e bartë markën e tij tregtare në momentin e vendosjes së këtij produkti në tregun e cilitdo shtet të Bashkimit Evropian.

Megjithatë, sikurse edhe shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, LMT i Kosovës aplikon parimin e ezaurimit nacional derisa Republika e Kosovës të anëtarësohet në Bashkimin Evropian (neni 12, paragrafi 1 i LMT). Pra, sipas kësaj të drejtat e bartësit të markës së regjistruar për të kontrolluar qarkullimin e mallrave apo shërbimeve do të pushojë vetëm kur këto mallra apo shërbime janë futur në tregun e Kosovës nga pronari apo me pëlqimin e tij. Për pasojë, në rast të importit paralel apo vendosjes së produkteve të caktuara (autentike) në tregun e Kosovës pa lejen e bartësit, i njëjti mund të kërkojë nga gjykata të ndalojë një veprim të tillë meqë ky veprim paraqet shkelje të markës tregtare të mbrojtur.

Neni 12 i LMT-së përcakton qartë se: *“humbja e të drejtës për ndalimin e përdorimit të markës për produkte dhe shërbime fillon me futjen e markës në tregun e Republikës së Kosovës nga ana e vet pronarit ose pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, në ndonjërin nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian apo shteteve që janë palë në Marrëveshjen që krijon Zonën Ekonomike Evropiane, me atë markë tregtare”* çka nënkupton se shterja e së drejtës sipas shitjes së parë bëhet vetëm në rastet kur bartësi i të drejtës së markës tregtare e shet

vet atë produkt apo përmes të autorizuarit të tij, në territorin e Republikës së Kosovës, por kjo e drejtë nuk konsumohet nëse produkti është shitur jashtë Republikës së Kosovës, si në rastin konkret.

Prandaj duke u nisur nga të sipër cekurat Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se i padituri me importimin e mallrave kontestuese dhe vënien e tyre në treg e ka shkelur markën tregtare të paditësit dhe në këtë kuptim vlerëson Nenin 97 të LMT-së, i cili në par.1 përcakton se: *“Pronari i të drejtës së markës tregtare mund të inicioj procedurë gjyqësore kundër çdo personi që ka shkelur të drejtat e markës tregtare duke kryer pa autorizim njërën nga veprimet e cekura në nenin 8, paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji, duke kërkuar që produktet që përbëjnë shkelje të markës tregtare të largohen nga tregu, të konfiskohen apo shkatërrohen me shpenzimet e shkelësit”*, sepse në produktet e të paditurit janë përdorur shenjat identike me markat tregtare të paditësit. Andaj edhe kjo gjykatë konsideron në rastin konkret, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për shkatërrimin e produkteve kontestuese është në proporcion të plotë me shkeljen e të paditurës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë,
K.DH.SHK.II.II.nr.832/24, dt.12.06.2024

**Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi d.v.**